



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

Njësia e Prokurimit

Gjilan, me datë: 21.09.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjilanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesave për ri-shqyrtim të dt. 19.09.2023 të parashtruara nga: *Operatorët Ekonomik "Eco Holding Group" sh.p.k* lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Ndërtimi i mini parqeve dhe tereneve sportive në fsh.Demiraj , fsh.Dobërçan dhe në lagjen Bujana ne Komunën e Gjilanit "** me nr të prokurimit **651-23-9276-5-2-1** dhe Nr te brendshëm **GI 651 23 -057 -521** nxjerr:

V E N D I M

Aprovohet pjesërisht – kërkesat për ri-shqyrtim të *Operatorëve Ekonomik "Eco Holding Group" sh.p.k* lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Ndërtimi i mini parqeve dhe tereneve sportive në fsh.Demiraj , fsh.Dobërçan dhe në lagjen Bujana ne Komunën e Gjilanit "** me nr të prokurimit **651-23-9276-5-2-1** dhe Nr te brendshëm **GI 651 23 -057 -521** dt. 19.09.2023 kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK të datës **03.02.2023** të publikuar në platformën e prokurimit elektronik.

1. AK – Kuvendi Komunal i Gjilanit –Njoftimi per Kontratë të datës 01.09.2023
2. Autoritet Kontraktues , vendos që të bëjë korigjimin e Dosjes së Tenderit , duke Korigjuar në harmoni me LPP dhe po ashtu do të vazhdohet me këtë aktivitet .
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <http://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "Eco Holding Group" sh.p.k ka parashtruar **Kërkesë për rishqyrtim** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Ndërtimi i mini parqeve dhe tereneve sportive në fsh.Demiraj , fsh.Dobërçan dhe në lagjen Bujana ne Komunën e Gjilanit "** me nr të prokurimit **651-23-9276-5-2-1**

dhe Nr te brendshëm **GI 651 23 -057 -521**. Autoriteti Kontraktues me datë **21.09.2023** ka shqyrtuar kërkesat në fjalë:

Autoriteti kontraktues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës për rishqyrtim të parashtruara nga ana e OE dhe me pretendimin se Ak ka vepruar ne Kundershtim te LPP-Së

Autoriteti kontraktues pas shqyrtimit te pretendimit ankomore te paraqitur ne Kerkesen per Rishqyrtim e parashtruasit , shqyrtimi te shkresave ter lendes , vlersimi dhe analizes konkrete ne mënyrë të drejt te fakteve dhe provave administrative , gjejtj dhe e konstatoi se Kërkesa për Rishqyrtim të parashtuesëve Apovohet si pjesërishtë e bazuar pasi që AK konstaton se duke marr parasysh që vlera e projektit është vlerë e mesme.

Pretendimi ankimor

Pika 1. Kërkesa 1 .OE duhet te ofroj deshmi te kenaqshme se qarkullimi vjetor i OE , gjatë 3 vitetve te fundit ka qene ne vler , se bashku ne te tri vitet e fundit prej jo me pak se 340,000.00 euro .Ne rast koncerciumi lideri duhet te ket te pakten 60% te vleres se kerkuar .

Kjo kerkes konkretisht pjesa "Ne rast te koncerciumit lider duhet te kete te pakten 60% te vleres se kerkuar " eshte shum diskriminuese per faktin se pse dueht nje OE qe ka vleren me te madhe te qarkullimeve vjetore te ipet epiteti "Lider " , ndersa ka shanca qe kompania e cila merr persiper plotsimin e te gjitha kritereteve madje edhe perfundimin e projektit ne tersi te mos mund te jet lider ne projekt , pra ketu shkaktohet shkelja e vet dispozitave te LPP Konkretisht AK po bene shkelje:

Te neni 7:Barazia ne Trajnim /Jo –Diskriminim

Par.1 Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatoret ekonomik ne menyre te barabarte dje jodiskriminuese dhe do te veproje ne menyre transparente.

Neni 7., par.6 Gjate udheheqjese se aktiviteteteve te prokurimit, te gjitha autoritetet kontraktuese do te sigurojne; (i) pjesemarrjen sa me te gjere te mundshme te operatoreve te interesar ekonomik lidhur me cmimin dhe lenden e prokurimit; (ii) publiimin e rregullt, dergimin dhe/ose disponueshmerine e te gjitha njoftimeve, ftesave, informacioneve dhe dokumenteve qe kane te bejne me aktivitetin e prokurimit ne perputhje me kete ligj; (iii) eliminimin e praktikave, kritereteve, kerkesave dhe specifitimeve teknike qe diskriminojne ne favor ose kunder nje ose me shume operatoreve ekonomik...

Kerkesa1. Operatori ekonomik duhet te ofroj deshmi se ka perfunduar me sukses kontratate natyres se ngjashme me natyren e aktivitetit se paku nje teren sportiv te realizuar gjate tri vitet e fundit per periudhen e shkuar tre vjeqare jo me pak se 300,000.00euro Ne rast te koncerciumi lideri duhet te kete te pakten 60% te vleres se kerkuar

Konkretisht: "Ne rast koncerciumi lideri duhet te kete te pakten 60% te vleres se kerkuar"

Arsyetimi jone lidhur edhe me kete pike eshte i njejte, ju si AK keni te drejte te kerkon i referenca te natyres se ngajshme me aktivitetin e gjitha kjo si deshmi qe OE qe oferton te deshmohet se eshte i afte te perfundoj kete projekt ashtu siq ka perfunduar edhe me pare ne baze te referencave, mirpo e njejta vazhdon pse duhet te ipet epiteti lider nje OE tjetere?

Keto kërkesa bejne shkelje te LPP duke e ulur konkurrencen dhe duke veshtiresuar poziten e OE te interesuar pa nevoje, AK duhet te vazhdoje ti ofroje secilit OE dosjet dhe hapësira ne projekte dhe jo kufizime.

Ne kerkojm heqjen e 60% (Liderit) per te dyja pikat, ose tutje jemi te gatshem te vazhdojm me procedura ne instanca me te larta.

Përgjigja Në pretendimin ankimor .

Kemi bërë korigjimin e DT dhe Njoftimit per Kontratë në këtë pik ,Andaj Bazohun I tek Versioni I Korigjuar tek Dosja e tenderit dhe **B54 Formulari standard per korigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara**

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;
Arkivit të Komunës.

Kujtim Bajrami
Zyrtar përgjegjës i Zyrës së Prokurimit

